



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-06063-46431 dt. 20/09/ 2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, më datë: **30.9.2024** (e hënë) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbal i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. **30.5.2024**
2. Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. **06.06.2024**.
3. Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. **06.09.2024**.
4. Procesverbal i mbledhjes së jashtëzakonshme e dt. **13.9.2024**
5. Propozim vendim për Financimin e projektit.
6. Propozim vendim për aprovimin e Planit të punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Drenas (2024-2027)
7. Të ndryshme.

Drenas, 20.9.2024



Anëtar i më i vjetër i Kuvendit Komunal

Gani Krasniqi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-29068 dt. 19/06/2024

PROCESVERBALI

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **30.05.2024** e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 31 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Kosovare Halilaj Karaxha (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK).

Rend dite:

- 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal Drenas i mbajtur më dt. 29.04.2024.**
- 2. Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re.**
- 3. Të ndryshme.**

Të pranishëm ishin edhe **Nënkryetari i Komunës Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, zyra e informimit.**

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 30.05.2024, ku për diskutim ishin 3 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari. Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës:

Arigon Sinani- duke u bazuar në ligjin Për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së si dhe Rregullores së Kuvendit Komunal Drenas kërkoj që të futet një pikë shtesë e rendit të ditës shkarkimi i kryesuesit të Kuvendit Komunal të Drenasit.

Muhedin Salihu- edhe ne anëtarët e subjektit politik DD kem edhe një pikë shtesë, duke ju referuar ligjit Për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores së Kuvendit Komunal të Drenasit kërkojmë nga ju që të ndërrohet anëtari i Komitetit për Politik dhe Financa nga radhët e DD-së z.Hamit Haxhiu pasi që i njëjti nuk e përfaqëson më subjektin politik të DD-së për arsye se ka dal si i pavarur dhe sipas çelësit të përfaqësimit të subjekteve politike në KPF subjektit politik nga DD i takojnë dy anëtarë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- sa i përket pikës së propozuar nga Arigon Sinani shkarkimi i kryesuesit, më lejoni që të ju them që kjo si mbledhje e rregullt është e drejt e juaja me propozu, mundësisht me respektua Udhëzimin Administrativ. Për këtë pikë të rendit të ditës i bëni nënshkrimet e thirrni mbledhje të jashtëzakonshme edhe vazhdoni me procedurat kjo është ajo që ju duhet me vepru.

Labinot Halilaj- ne pretendojmë që jemi brenda procedurave administrative dhe për shkarkimin e kryesuesit tani në seanca të rregullt, ne insistojmë që të hedhet në votim nëse eventualisht nuk e hidhni në votim doni me mbyll seancën e rregullt atëherë e mbyllim seancën vetëm ta dimë që ti nuk po e hedh në votim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- kërkoj 15 minuta pauzë deri sa të konsultohemi me MAPL-në nëse munden me na e dhenë një informacion konkret.

Beqir Kiqina-kërkoj që të shtyhet seanca deri në orën 12 pasi që është përvjetori i dëshmoreve Rasim Kiqina dhe Ragip Halilaj, me i krye homazhet në mënyrë institucionale së bashku pastaj të vazhdojmë aty ku kemi mbet

Nënkryetari i Komunës Arben Shala- ju njoftojmë se nisja për në homazhe bëhet në ora 10:40 i gjithë stafi me drejtor. Desha të ju njoftoj se jemi komuna e parë në transparencë parametër ky është një rezultat i qeverisjes së mirë, rezultat i transparencës është bërë me kritere të matshme nga KDI një organizatë shumë kredibile i falënderoj të gjithë për kontributin e dhënë.

Egzona Tërdevci- paraprakisht kur e keni caktua mbledhjen ju e keni dit që data 30 është dita e heronjve tonë Rasim Kiqina dhe Ragip Halilaj, nuk është hera e parë që jemi duke e mbajt mbledhjen me datën 30 e kemi mbajt edhe para dy viteve nuk e kemi pas konsiderata njerëzor duke e dit që një koleg i joni e ka përvjetorin e babës në këtë dit keni pas mundësi me shty për një datë tjetër kështu që tash nuk më doket e drejtë pse ju nuk e keni menaxhua me i caktua me një kohë tjetër seancën e një kohë tjetër homazhet ne me prit për një orë e gjysmë për këtë punë.

Arigon Sinani- për shkak që Drini e ka përvjetorin e babës ai nuk mundët me ardh më vonë në seancë andaj kërkoj që pauza të jetë 15 minuta dhe të kthehemi ta kryem mbledhjen pastaj vazhdojmë me homazhe.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- kërkoj 15 minuta pauzë

Pas pause:

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- mbledhja është hap me rendin e ditës po të njëjtën kohë kemi edhe propozime shtesë, si pikë shtesë është shkarkimi i kryesuesit. Arsye e pauzës ishte kjo që na duhet konsultim faktikisht të gjithë anëtarët e kuvendit kanë të drejtë të propozojn pikë shtesë mirëpo nuk e specifikon askund nuk është e shkruar si pikë shtesë shkarkimi i kryesuesit unë konsideroj që propozimi është valid po nuk i jap vetës të drejt në aspektin procedural dhe nuk e di a kem të drejt këtë mbledhje a jo. Në bazë të praktikave që i kemi pa, thirret mbledhje e jashtëzakonshme i bëni nënshkrimet unë jam këtu bashkë me sekretarin. Në momentin që nënshkrimet janë valide 11 nënshkrime ose 1/3 e anëtarëve të kuvendit atëherë mbledhja thirret, nuk besoj që është pikë e ngutshme, prap po them që nëse për mua nuk është e ngutshme për ju ndoshta është e ngutshme. Në rast se unë po e shkeli rregulloren prap është ajo që ju keni të drejtë me ju drejtua MAPL-së me thënë se kryesuesi e ka shkel rregulloren. Me kaq e përfundoj mbledhjen e datës 30.05.2024.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 13:05 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 30.05.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Indire Olluri Thaqi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-29067 dt. 19/06 2024

PROCESVERBALI

Të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **06.06.2024** e cila filloi në orën 10:24. Mbledhja e jashtëzakonshme është thirrë në bazë të kërkesës të 16 (gjashtëmbëdhjetë) këshilltareve Komunal të datës 30.05.2024 me nr. 02/070/01-25791,

Mbledhjen e kryesoi Azemine Bujupi Gjoka në mungesë të Kryesuesit i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesja deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 16 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Arigon Sinani (PDK) Hamit Kastrati (PDK), Qendrim Mulaj, Kosovare Halilaj Karaxha (PDK), Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Arbër Halilaj (GREEN).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së, qytetar, media.

Mbledhja filloi punimet vetëm me këtë pikë të rendit të ditës

1. Shkarkimi i Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Në mungesë të kryesuesit mbledhjen e kryesoi Azemine Bujupi Gjoka si anëtare më e vjetër prezent gjatë mbledhjes së jashtëzakonshme, ku njoftoi me rendin e ditës e lartcekur.

Diskutime për rendin e ditës.

Azemine Bujupi Gjoka, hodhi në votim rendin e ditës: votimi u bë me ngritje dore, prezent gjatë votimit ishin gjashtëmbëdhjetë (16) anëtar, **“Për”** votuan 16 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Arigon Sinani, E nderuar udhëheqëse e seancës së Kuvendit të Komunës së Drenasit të nderuar asamblistë e Komunës së Drenasit, pasi unë në mbledhjen e kaluar kam marrë iniciativë dhe kam propozuar për këtë pikë të rendit të ditës, po ndihem i obliguar që t'i paraqes në pikat e shkurtra të shkurtra arsyetimet që na kanë sjellë deri të propozimi i kësaj pike: 1. Mos ruajtja e kompaktësisë së Kuvendit, kryesuesi ka dështuar që të sigurojë një atmosferë bashkëpunuese brenda këtij Kuvendi ky mosbashkëpunim ka ndikuar negativisht në efektet dhe funksionalitetin e Kuvendit. 2. mos moszbatimi i Rregullores së Kuvendit, veçanërisht gjatë procedurave të numërimit të votave, ku vazhdimisht i kemi tërhequr vërejtjen. 3. Moslejimi i propozimit të kuvendarëve, Kryesuesi ka penguar propozimet dhe iniciativat e kuvendarëve duke shkelur kështu të drejtat e tyre për të paraqitur çështjen dhe

për të ë dhe për të marrë pjesë aktivisht në proceset e vendimmarrjes ky veprim është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet e demokracisë dhe vetëqeverisjes lokale. 4. Lejimi i gjuhës degraduese në Kuvend. Kryesuesi ka lejuar përdorimin e gjuhës degraduese dhe ofenduese gjatë seancës së Kuvendit, gjë që cenon dinjitetin dhe respektin e nevojshëm për një institucion demokratik, Gjuha degradues zakonisht ka ardhur nga kryetari i komunës duke e fyer asamblistët dhe kryesuesi asnjëherë nuk ka marrë masa, madje as nuk ka arritur që të detyrojë të tërheqë fjalën. 5. Tërheqja e pikave të rendit të ditës pa votim dhe miratim të kuvendarëve, kryesuesi ka tërhequr vazhdimisht pikat e rendit të ditës pa i hedhur ato në votim dhe miratim të asamblistëve, duke penguar kështu shqyrtimin dhe diskutimin e çështjeve të rëndësishme për komunitetin tonë. 6. Mos prezenca e kryesuesit të kuvendit sot dëshmon më së miri se ai çdoherë i ka shkuar për shtati i ekzekutivit dhe kryetarit të komunës, asnjëherë nuk ka arritur që në këtë Kuvend të pavarësojë. 7. Gjithashtu si shkelje e Rregullores së Kuvendit dhe ligjit, është edhe mbledhje e fundit e thirrur nga vetë kryesuesi dhe mbyllje në mënyrë arbitrare nga ai ende pa filluar mbledhja, pa votim, por në bazë të direktivave të marrura nga kryetari i Komunës. Prandaj, bazuar në të gjitha këto që u thanë më lart, me nënshkrimin e gjashtëmbëdhjetë asamblesë është thirrur kjo mbledhje dhe ju bëj thirrje që të votoni shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit, sepse ky Kuvend ka nevojë për më shumë transparencë dhe llogaridhënie.

Marigona Bazaj, duke e vlerësuar situatën në Asamblenë Komonale në Drenas, që nga konstituimi i saj kemi parë shumë defekte në udhëheqjen e seancave dhe si rezultat edhe shkelje të Rregullores së Punës në Asamble, duke ndërhyrë kryetari i komunës gati çdoherë, për çdo gjë, në zhvillimin normal të seancave të asamblesë, Prandaj, duke iu referuar Rregullores së Punës së Asamblesë dhe Ligjit për Qeverisjen Lokale, ku konsiderojmë se kryesuesi aktual i asamblesë, zotëri Milaim Hajdari, nuk e ka përmbushë detyrën për të cilën është zgjedhur, kërkojmë që të bëhet shkarkimi i tij.

Egzona Tërdevci, e nderuar kryesuese Azemine Gjoka, të nderuar kolegë asamblesë, të dashur bashkëqytetarë të Drenasit, mysafirë prezentë, mediat e nderuara, më lejoni që para jush së pari të paraqes turpin dhe sjelljen e paprecedentë ndaj dëshmorëve të Kombit, që ka bërë Komuna e Drenasit bashkë me PDK-në dhe akterët e saj në homazhet e datës tridhjetë maj në nder të heronjeve të Rasim Kiqina dhe Ragip Halilaj. Atë ditë, delegacioni nga komuna e Drenasit ishte udhëhequr nga nënkryetari i Komunës, z.Arben Shala dhe siç duket, për z.Shala të tjerët në Komunën e Drenasit dhe për PDK-në dëshmorët nuk janë të njëjtë. Atë ditë, përkundër që z.Shala e ka ditur që ka një buqet tjetër me lule në veturë, ai ka zgjedhë që me lule të freskëta ta ndërrojë vetëm varrin e Rasim Kiqinës, por jo edhe atë të Ragip Haliaj. Prandaj, dorëheqja e tij është dashur të dorëzohet qysh me tridhjetë maj, e në situatën kur ai nuk dorëhiqet, do duhej të shkarkohej nga kryetari i Komunës. Një sjellje e tij fyese dhe e turpshme ndaj dy bashkëqytetarëve që kanë rënë në të njëjtën ditë, nuk është parë asnjëherë më herët në komunë secili e ka gojën plot me lavde e nderime për dëshmorët e kombit, por situata e tridhjetë majit ua ka shfaq maskën të gjithëve. Për Komunën e Drenasit, PDK-në dhe në veçanti nën kryetarin Shala, si udhëheqës i delegacionit zyrtar Idenë për të vendosë lule tek varri i tij paska qenë vetëm Rasim Kiqina, po jo edhe Ragip Halilaj, vetëm sepse djali i tij ka orientim ndryshe nga komuna e Drenasit. Datën e tridhjetë majit lulet e blera të planifikuara për dëshmorin Ragip Halilaj u kthyen prapë në Drenas, sepse nënkryetari i Komunës, zotëri Arben Shala, nuk e tejkaloi dot inatin personal që ka pse djali i dëshmorit mendon ndryshe nga ajo e bashkëpartiakët e tij, secili pjesëmarrësi i atij delegacioni atë ditë

do të duhej të ndihej i turpëruar që ka qenë pjesë e një skeme të tillë që ofendon gjakun e dëshmorëve dhe sjelljen fyese ndaj tyre. Ata që janë përjetësuar bashkë, nuk mund t'i ndajë as Komuna e Drenasit, as nënkryetari, as PDK-ja, tash pas luftime. Secili pjesëmarrësi i atij delegacioni e mban mbi vete turpin që ka qenë pjesë e një organizimi të tillë për për këtë përgjegjësinë kryesore e mban Komuna e Drenasit, e këtë rast, z. Arben Shala, si nënkryetar dhe udhëheqës i delegacionit në mungesë të kryetarit në një situatë të tillë, po të kishte pak sado morale e fytyrë, ai nënkryetar qysh a ditë do të reflektonte përcjelljen e tij dhe të dorëzonte dorëheqjen, por meqë ai është i paturpshëm, nuk e presim një sjellje të tij të tillë dhe shkarkimet e tij nga këtu ia kërkojmë kryetarit Lladrovci. Duke qenë vetë familjar dëshmor, e nuk besoj që kryetari i Komunës sonë ia lejon një sjellje të tillë nën kryetarit të komunës. E në rrethanat kur zotëri Lladrovci nuk merr hapa për shkarkimin e tij, atëherë ne kemi të drejtë të besojmë që ndarja e dëshmorëve atë ditë është bërë me direktivat e tij edhe nga larg. Me gjithë dallimet politike dhe keqqueverisje, ne ende kemi shpresë se zotëri Lladrovci do të reflektojë për sjelljen e zotëri Shala dhe do ta shkarkojë atë duke ndëshkuar për një veprim të tillë fyese ndaj luftës Çlirimtare të Kosovës. Një komunë që ka dhënë kaq shumë për lirinë e Kosovës dhe e cila në stemen e saj e mban shqiponja dykrenare, nuk i bën nder shërbimi i Arben Shalës, si nënkryetar i komunës. Prandaj, nga këtu në emër të Vetëvendosjes, po besoj që në këtë iniciativë na bashkoni të gjithë, kërkoj që zotëri Shala të dorëhiqet, e nëse ai nuk pranon të dorëhiqet, e lusim kryetarin e Komunës që ta shkarkojë atë. Në rast se nuk shkarkohet, ne do të organizohemi aksionet deri në shkarkimin e tij, sepse ne nuk mund të jemi pjesë në një komunë ku dëshmorët ndahen për preferenca partiake. Sa i përket pikës për të cilën jemi mbledhur, si Vetëvendosje pajtohemi plotësisht që zotëri Milaim Hajdari nuk duhet të jetë më kryesues i kuvendit komunal në Drenas. Në fakt, nga përbërja e Kuvendit Komunal, kryesuesi që në fillim është dashur t'i takojë opozitës, por ja që atëherë ishin blerë votat ishin shitur mjaftueshëm sa për ta siguruar kuorum e për ta zgjedhë zotërin Hajdari kryesues. Hajdari nuk ka qenë asnjëherë në nivel të detyrës në rolin e tij si kryesues, të gjithë ne në këtë Kuvend, por edhe qytetarët që i përcjellin seancat, jemi dëshmitarë se në seancat e kuvendit komunal, agjendat, dinamikat e gjitha çështjet e punës së kuvendit janë përcaktuar nga zotëri Lladrovci si kryetar komune, e jo nga kryesuesi i kuvendit komunal. Asnjëherë nga marrja e mandatit Komiteti për Politikë dhe Financa nuk është marrë parasysh si trupë funksionuese, mbledhjet e këtij Komiteti më shumë janë mbajtur për formalitet sesa që ju është vlerësuar mendimi i anëtarëve rreth përcaktimit të pikave të seancave për Kuvendin Komunal. Shkeljet e z. Hajdarit janë të shumta, por po mundohem t'i përmbledh në disa pika të shkurtra. Në seancën e datës njëzet e shtatë prill dy mijë e njëzet e dy zotëri Hajdari bashkë me zotërin Lladrovci kishin provuar ta kontrabandojnë një vendim të dëmshëm për disa banorë në Drenas me vetëm pesëmbëdhjetë vota. Pra, pa e siguruar kuorumin e nevojshëm prej gjashtëmbëdhjetë votave, por pas reagimeve tona si asamblistë, PDK-ja ishte detyruar që një kolege tonë ta sjellë nga pushimi i lehonisë për të votuar. Zotëri Hajdari, megjithëse obligohej ndryshe me ligj, në shumë situata nuk ka hedhur fare në votim propozimet tona si Asamblesë për plotësim të rendit të ditës duke na mohuar të drejtat tona bazike nga pozicioni që kemi si asamblistë. Ka edhe më shumë, por para jush po i paraqes dy shkelje që zoti Hajdari ka bërë në këtë aspekt. Kur po e diskutonim ndryshimin e Rregullores për taksa dhe tarifa, asnjë nga propozimet tona nuk u hodh në votim, duke u anashkuar plotësisht si asamblist megjithëse ne kemi të drejtë që në secilën rregullore që diskutohet publikisht të bëjmë propozimet tona, por më skandalozja është kur ajo as planin e punës nuk pranoi ta hidhte në diskutim e as nuk na pranoi

propozimet tona kur plani i punës dihet që është vetë për punën e Kuvendit ku ndoshta kontributin më të madh në atë plan do të duhej ta kishim ne si asambleistë. Kur jemi të plani, një plan i tillë është veç në letër, se nga janari i vitit 2024 ne asnjë seancë nuk e kemi mbajtur në bazë të planit të punës, por janë caktuar ad hok dhe sipas dëshirave individuale. Zotëri Hajdari ka lejuar vazhdimisht sjellje joetike dhe sulme në baza personale të kryetarit të komunës ndaj nesh si asamblist, e në këtë rast, unë që po flas para juve, jam përballë disa herë me sulme, madje edhe seksiste, nga kryetari i Komunës, e zotri Hajdari nuk e tërheq vërejtjen ndaj tij, as nuk ka marrë asnjë hap. Duke qenë kryesues, ai është dashur të përkujdeset me Sekretarin e Kuvendit që asambleistët t'i kenë materialet e seancave me kohë por ne që jemi këtu e dimë se sa herë i kemi marrë materialet e mangëta e jashtë afateve zyrtare duke marrë parasysh të gjitha këto shkelje, por edhe ato që ndoshta kemi harruar t'i përmendim z. Milaim Hajdari duhet të shkarkohet sot dhe si Vetëvendosje ne i pajtohemi plotësisht me këtë propozim.

Arbër Halilaj, përshëndeti qytetaret e Komunës së Drenasit kolegët prezentë në asamble, mediat, të cilët të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Kuvendi Komunal i Drenasit që nga seanca inauguruese e deri tani shumë shpesh ka devijuar nga normaliteti i punës. Derivimi i rezultatit zgjedhor sa i përket përfaqësimit në Kuvend përmes fluturimeve politike korruptive të nxitura me qëllim të devaluimit dhe luftimit të rolit të opozitës si siguresë e demokracisë kanë ndikuar direkt raportet, bashkëpunimin dhe punën tonë brenda Kuvendit. Si rrjedhojë, roli dhe kompetencat e kuvendit komunal, siç janë përcaktuar në dokumente të qeverisjes lokale, nuk janë respektuar e zbatuar. Kryesuesi si drejtues i organit më të lartë legjislativ të komunës sonë ka dështuar të ngritet mbi interesat partiake dhe Kuvendit t'ia japë funksionin e ndërlidhësit ndërmjet qytetarëve dhe ekzekutivit, përmes zërit të kuvendarëve të zgjedhur. Disa nga mangësitë kryesore që janë shfaqur në punën e deritashme të kryesuesit janë si më poshtë: mungesa e profesionalizmit dhe pavarësisë, Kryesuesi nuk ka treguar aftësinë për të ushtruar kompetencat e pozitës pa ndikime anësore, dhe nuk ka njohur dhe zbatuar strikt Rregulloren e punës, që është një nga kërkesat dhe pritshmëritë bazike të detyrës, tolerimi i gjuhës së papërshtatshme, lejimi i përdorimit të gjuhës së papërshtatshme joparlamentare dhe fyerjeve në baza gjinore seksiste shkon kundër parimeve të respektit dhe barazisë që do pritet të mbrohen këtij kuvendit pikërisht nga kryesuesi përmes zbatimit të rregullorës, neglizhimi i propozimeve të këshilltarëve. Dështimi për të vënë propozimet e këshilltarëve në rendin e ditës përmes votimit injoron procesin demokratik dhe të drejtat e këshilltarëve për të pasur barazi në debat. Dështimi për të favorizuar unitetin, pamundësia e kryesuesit për të krijuar një frymë mirëkuptimi, korrektesie e kolegialiteti dhe në vend të kësaj nxitje e ndarjeve partiake, ka minuar integritetin e Kuvendit dhe qëllimin e tij për t'i shërbyer të gjithë anëtarëve në mënyrë të barabartë, ndikimi nga kryetari i komunës mbajtja e seancave kryesisht nën tutelën e kryetarit të komunës në çdo aspekt sugjeron mungesë të pavarësisë dhe integritetit personal në zbatimin e ligjit, Rregullores dhe procedurave të Kuvendit, mosrespekti ndaj këshilltarëve, lejimi i nënvlerësimit të këshilltarëve nga zyrtarët ekzekutivë ose kryetari është i papranueshëm dhe tregon një dështim për të mbrojtur dinjitetin e anëtarëve të Kuvendit ky dinjitet është shkelur edhe nga vetë kryesuesi. Kujtojmë seancën e rregullt para një jave, kur në mënyrën më të paskrupullt është luajtur me dinjitetin tonë, duke na lënë në pritje në sallë, në një seancë të shtyrë, sipas qejfit kryesuesit dhe ekzekutivit, sa kohë që kanë dashur duke marrë parasysh këto dhe pikat tjera që nuk i ceka, bashkë me shfaqjen e një shumice të re brenda Kuvendit është brenda normave demokratike për të kërkuar shkarkimin e kryesuesit aktual me synimin e caktimit të një drejtuesi tjetër të Kuvendit që do të mund të rikthente

efikasitetin kolegjalitetin dhe qeverisjen e duhur, bazuar në kompetencat dhe prioritetet e Kuvendit. Kryesuesi i ri duhet të jetë dikush që sinqerisht angazhohet për të avancuar punën e Kuvendit, duke siguruar zbatimin e obligimeve dhe kompetencave të përcaktuara duke nxitur një mjedis respektues dhe gjithëpërfshirës, si dhe duke insistuar në parimet e transparencës dhe llogaridhënies Vota ime e sotme, si përfaqësues i GREEN për Drenas pro shkarkimit të kryesuesit, është së pari lirim i tij nga presioni i pozitës që nuk e zotëron dhe mësim për të gjithë, se me intriga e devijim të vullnetit të qytetarëve nuk shkohet përpara.

Mërgim Pirraku, po paraqitem me paraqitë një qëndrim personal gjatë përgatitjes së këtij fjalimi jam munu me qenë shumë objektiv, pra mos me qenë subjektiv dhe mos mu munu me ia mbajtë anën askujt. Të nderuar, sot jemi mbledhë për të diskutu një çështje shumë të rëndësishme dhe shumë të ndjeshme me rëndësi të veçantë për Kuvendin dhe për të ardhmen e qytetit tonë. Fillimisht dua të bëj të qartë se ky moment nuk është i lehtë për mua personalisht, dhe besoj se askush nga ju nuk po ndihet mirë se kemi ardh në këtë pikë. Kryetari i Kuvendit, i nderuari Milaim Hajdari, është një personalitet i respektuar nga të gjithë ne, megjithatë ne mendojmë se opozita në Kuvend e meriton postin e kryetarit të Kuvendit. Pra, edhe një herë po me përsëritë, ne jemi shumica në këtë Kuvend dhe ne e meritojmë një kryetar i cili kish me qenë i pavarur dhe i cili do të na mundësonte t'i balanconte forcat politike në këtë Kuvend. Ne e dimë që kohën e fundit jemi dëshmitarë që shumë procese i kemi shty pra për muajt në vazhdim pra, kemi pas ngecje të punimeve brenda këtij Kuvendi, dhe detyra ime si anëtarë i Kuvendit është të ndjek parimet dhe qëllimet për të cilët jam zgjedhur besoj se për të mirën e vendit edhe për të përmbushur pritshmëri të qytetarëve është e nevojshme të bëhen ndryshimet në udhëheqjen e Kuvendit. Balancimi i forcave të pozitë të pozitës dhe të opozitës brenda Kuvendit për vlerësimin tim politik edhe besoj që jam objektiv, është modeli më i shëndetshëm dhe më i mirë për të kryer punët që na pres ky balancim i forcave politike do të garantonte saktësinë e vendimeve që ky Kuvend si organi më i lartë vendimmarrës për qytetin tonë do të marrë në të muajt në vazhdim. Kjo është formula, pra po them sipas mendimit tim, që do të zgjidhte më mirë dhe më saktë punët që na presin. Ky vendim nuk është një reflektim cilësive personale të kryetarit të Kuvendit, z. Hajdari, por është një vendim i duhur politik, që vjen nga një analizë e thellë dhe strategjike për drejtimin që duhet ta marrë ky Kuvend, ne kërkojmë një qasje të re një kryesues nga opozita që do të ishte i pavarur nga pozita, dhe do të mundësonte avancimin e agjendave politike të përbashkëta të pozitës dhe të opozitës vetëm ato që janë të mirë të qytetarëve dhe për qytetin tone shpresoj që të gjithë ne, si anëtarë të Kuvendit, të mbajmë në mend të mbajmë në kujtesë se pavarësisht dallimeve tona politike, jemi këtu për të shërbyer interesave të qytetarëve. Ndryshimi është pjesë e procesit demokratik dhe duhet të pranohet si një mundësi për përmirësim dhe progres. E falënderoj kryetarin e Kuvendit, z. Hajdari, për punën e tij dhe shpresoj që bashkëpunimi ynë të vazhdojë të jetë konstruktiv, pavarësisht rezultateve që do të kemi sot.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesja e mbledhjes Azemine Bujupi Gjoka keqroq qw meqë vendimet e Kuvendit merren me votim "Për" kundër ose abstenim të shumicës së anëtarëve, unë kërkoj që së pari të përcaktojmë mënyrën e votimit dhe duke u bazu në nenin 16 pika 4 të Rregullores së punës si dhe nenin 48 të Ligjit për vetëqeverisje locale, A kemi propozim për mënyrën e votimit nga anëtarët e Kuvendit, sa i përket pikës që po e diskutojmë?

Arbër Halilaj, meqë Ligji për vetëqeverisje lokale dhe rregullorja e punës e përcakton votimin në disa mënyra, unë propozoj që në këtë rast, për shkak që jemi të gjithë prezentë ne propozuesit e mbledhjes, të shkojmë me opsionin e pare të nenit gjashtëmbëdhjetë pika katër, që është votim i thjeshtë “për” “kundër” “abstenim” do të thotë me ngritje dore.

Kryesuesja e mbledhjes Azemine Bujupi Gjoka konstatoj se sipas propozimit të anëtareve të kuvendit votimi do të behet me ngritje dore prezent janë gjashtëmbëdhjetë këshilltarë, kështu që kemi kuorumin për votim. Atëherë, votojmë propozimin e votimit të thjeshtë, me ngritje dore, propozuar nga Arbër Halilaj.

Prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, “Për” votuan 16 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua mënyra e votimit, pra votimi i thjeshtë me ngritje dore.

Meqë nuk pati diskutime të tjera dhe u votua mënyra e votimit Kryesuesja e mbledhjes Azemine Bujupi Gjoka hodhi në votim pikën e vetme të rendit të ditës: Shkarkimi i Kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Prezent gjatë votimit ishin 16 anëtar, “Për” votuan 16 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati u miratua pika e rendit të ditës **Shkarkimi i Kryesuesit të Kuvendit Komunal.**


Votimi u bë i thjeshtë me ngritje dore.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 10:51 min.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 06.06.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.


<https://www.youtube.com/watch?v=aWfLyuh7nf4>

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi e mbledhjes


Azemine Bujupi Gjoka



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/03-4644 dt. 20/09/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **06.09.2024** e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi Anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës. Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 17 anëtarë:

Bekim Lestrani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK), Hamit Haxhi, Muhamet Kurtaj (VV), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK), Selman Qallapeku, Kosovare Halilaj (PDK) Milaim Hajdari (PDK) *Nuk morën pjesë në seancë 14 anëtar.*

Të pranishëm ishin edhe Nënkryetari Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, zyra e informimit.

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Betimi i asamblistit të ri, Selman Qallapeku, nga subjekti politik “Vetëvendosje” i cili zëvendëson asamblistin Drin Halilaj pas dorëheqjes.

Mbahet Mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Drenasit

Më datë 06.09.2024, rreth orës 10:00, u mbajt mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Drenasit, e cila u thirr në **bazë të nenit 44, pika 44.1, 44.2 dhe 44.3 të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, neni 6 të Udhezimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015.**

Kjo mbledhje kishte në rend dite betimin e assembleistit të ri, **Selman Qallapeku**, nga subjekti politik “Vetëvendosje”. Ai zëvendëson asamblistin **Drin Halilaj, i cili dha dorëheqje nga pozita e tij më 21.08.2024.**


Anëtari më i vjetër i Kuvendit të Komunës Gani Krasniqi njoftoi me rendin e ditës dhe hodhi në votim piken e rendit të ditës, ku prezent gjatë votimit ishin 17 anëtar dhe votuan me 16 anëtar “Për” kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

z. Selman dha betimin para asamblesë komunale me tekstin e poshtë shënuar: Unë, Selman Qallapeku, ”betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej, me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si anëtare e Kuvendit të Komunës së Drenasit (Glllogoc), në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Pas dhënies se betimit të z. Qallapeku nuk pati diskutime dhe mbledhja përfundoi rreth orës: 10:30.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 06.09.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Anëtar i më i vjetër i Kuvendit të Drenasit


Gani Krasniqi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/23-46437 dt. 13.09.2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit Komunal të Drenasit të mbajtur më datë:
13.09.2024

Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit Komunal: Gani Krasniqi

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë.

Kuvendi filloi punimet më këtë :

Rend dite:

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
2. Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake

Prezent gjatë mbledhjes se rregullt ishin 30 anëtar të Kuvendit Komunal, Kryetari i Komunës së Drenasit Ramiz Lladrovci, Nënkrjetari i komunës Arben Shala si dhe stafi i kryetarit.

Gani Krasniqi, E hapi mbledhjen e Kuvendit të Komunës, fillimisht në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse konstatoj se **prezent ishin 30 anëtar**, andaj kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë, dhe njoftoj me rendin e ditës:

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime Gani Krasniqi hodhi në votim rendin e ditës ku të pranishëm ishin 30 anëtar dhe të gjithë votuan në mënyrë unanime.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, sipas proceduarave ligjore, fillimisht duhet:

➤ **Ngritja e Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit.**

Gani Krasniqi -kërkoj nga anëtarët e Kuvendit Komunal të votojnë përbërjen e komisionit, ku të gjithë ishin që komisioni të përbëhet nga 5 anëtar.

Bekim Lestrani-shefi i grupit Parlamentar i PDK-së, propozuan Valentina Leku Gashi për anëtar të komisionit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Azemine Bujupi-Gjoka, nga Grupi parlamentar i DD propozoi për anëtar të komisionit Mehedin Salihu.

Nga Grupi Parlamentar VV **Egzona Tërdevci** propozoi për anëtar të komisionit Filloreta Bujupin.

Nga Grupi Parlamentar LDK **Egzon Qorri** propozon për anëtar të komisionit Beqir Kiqina.

Nga Grupi Parlamentar GREEN Arbër Halilaj propozon për anëtar të komisionit Egzon Qorri.

Gani Krasniqi, fton anëtarët e Kuvendit Komunal që të votojnë komisionin me përbërje prej:

1. **Valerentina Leku Gashi- PDK**
2. **Mehedin Salihu- DD**
3. **Filloreta Bujupi- VV**
4. **Beqir Kiqina- AAK**
5. **Egzon Qorri- LDK**

Pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime Gani Krasniqi hodhi në votim Komisionin për zgjedhje të kryesuesit i cili u votua në mënyrë unanime nga të gjithë anëtarët e Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi: ftoj grupet e parlamentare që të propozojnë kandidatin për kryesues të Kuvendit Komunal.

Valentina Leku Gashi: nga grupi parlamentar i PDK-së propozon për kryesues të Kuvendit Komunal **Bekim Lestrani**.

Marigona Bazaj: nga grupi parlamentar i DD-së propozon për kryesues të Kuvendit Komunal **Arigon Sinani**.

Egzona Tërdevci: nga Grupi parlamentar i VV-së nuk ka propozim për kryesues

Arbër Halilaj: nga Grupi parlamentar i GREEN propozon për kryesues të Kuvendit Komunal **Arigon Sinani**.

Gani Krasniqi sqaroj mënyrën e votimit, sipas UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 2009/01 PËR PROCEDURËN E ZGJEDHJES DHE PËRGJEGJËSITË E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS, neni 3 pika 2 e sqaron se votimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit Komunal bëhet me vota të fshehta.

Kuvendi i Komunës shkoj me 15 min pauzë për arsye të përgatitjes së fletvotimeve
Pas 15 min. pauzë filloj me procedurat e votimit, votimi i zgjedhjes së kryesuesit bëhet me vota të fshehta

Fillon regjistrimi i votimit

Kryetari i komisionit Mehedin Salihu konstatoi se të pranishëm janë 31 anëtarë të kuvendit dhe votimi për kryesues filloi,

Komisioni ka konstatuar se nga 31 votues një votë ka qenë e pavlefshme

Mehedin Salihu- Kryetar i Komisionit pas procedurës se votimit për zgjedhjen e kryesuesit konstatoj se me rundin e parë u zgjodh për Kryesues të Kuvendit Komunal Bekim Lestrani me 17 vota, kunder Arigon Sinanit i cili kishte 13 vota, dhe një votë e pavlefshme

Me 17 vota për, Bekim Lestrani nga Partia Demokratike e Kosovës, është zgjedhur kryesues i kuvendit komunal deri në përfundim të mandatit 4 (kater) vjeqar, njejtë sikurse anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Pas zgjedhjes së tij me shumicë votash, Bekim Lestrani ka falënderuar kryetarin Lladrovci për besimin e dhënë dhe përkrahjen e asamblistëve për të udhëhequr kuvendin komunal.

Në seancë morën pjesë 31 anëtarë, dhe komisioni për mbikëqyrjen e procesit të votimit u përkujdes që procesi votimit të jetë konform legjislacionit në fuqi.

Kryesuesi i mbledhjes Gani Krasniqi hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës- **2.**
Propozim vendim për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake

Egzona Tërdevci- sa i përket kësaj pike po më vjen mirë që qeverisja ka reflektu te buxheti i ulët që ka nda për ujësjellës në vazhdimësi pra ka qen 200.000 euro dhe ka bë një bartje prej më shumë se 400.000 euro sado që është vonë mendoj që është njëri prej vendimeve të pakta të qëlluar që i keni, VV e mbështet këtë propozim.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi i mbledhjes hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 31 anëtar, **(Për)** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, 1 votë abstenim, u miratua pika e dytë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesmbajtëse

Indira Olluri Thaçi



Kryesuesi i mbledhjes

Gani Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas (Glllogocit)
Kuvendi Komunal



01-Nr- 400/01-95716 dt. 16/09/2024

Në veshtrim të nenit 58, paragrafi 1, nën-paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenit 34, pika 6 të Statuatit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 Nr. 320-19332 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Rregullores MF-NR 04/2017 mbi Kritret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, dhe Rregulloren 02-400/01-18380 për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullores për Ndarjen e subvencioneve, vendimit 01 Nr.400/01-26131, të dt. 03.06.2024, si dhe buxhetit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2024, me propozim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

**PROPOZIM VENDIM
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT**

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin “Shërbime të avancuara rehabilituese dhe trajtim gjithëpërfshirës social për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “Handikos”, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve për vitin 2024.

Neni 2

Projekti i Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”- “Ofrimi i Shërbime Sociale dhe rehabilituese sipas standardeve për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara”, përkrahjet në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2024.

Neni 3

Financimi- Subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike e shpenzimeve subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të parapara me Buxhetin për vitin 2024 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuara “HANDIKOS”, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimvendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga OJQ “HANDIKOS”, që të bëjë raport narrativ-me shkrim dhe financiar përmes zyrtarit monitorues në mënyrë që të njoftojë DSHMS-në për mënyrën e shpenzimit të mjeteve.

Neni 5

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit Komunal të Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale.



Arsyetimi

Bazuar në nenin 16 paragrafi 3, të Rregullorës MF-NR. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, Rregullores Nr. 12/320-19338, të dt. 07.04.2017 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, është formuar komisioni me Vendimin Nr. 01-400-01/12756 i datës 03.06.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike Nr.06-400/01-26133, të dt. 03.06.2024, të shpallur nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale për vitin 2024.

Komisioni ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionet e aplikantëve për subvencionim të OJQ-ve në bazë të thirrjes publike të lartëcekur, ku gjithsej kishin aplikuar gjashtë (6) OJQ:

Pas hapjes së zarfeve të OJQ-ve aplikuese, komisioni ka verifikuar dokumentacionet e dorëzuara të 6 organizatave aplikuese, si përfitues përcakton për mbështetje financiare Shoqatën e Përsoneve me Aftësi të Kufizuara "HANDIKOS" Drenas.

Meqë vlera e përkrahjes financiare në bazë të thirrjes publike është 5.000 €, kjo shumë do t'i ndahet kësaj OJQ-je, financimi- subvencionimi i projektit do të bëhet nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere/ kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760 të paraparë me Buxhetin për vitin 2024 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
ZYRA E KRYETARIT



Nr. 01-400/01-45715 dt. 16/09/2024

Në vështrim të nenit 58 par.1 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Që në vështrim të nenit 40 pika 40.2 të ligjit për vetëqeverisje Lokale, Vendimi Nr.01-030/01-17622 dt.13.04.2023, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e rregullt më datë _____ vitit 2024, aprovoi këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për Aprovimin e Planit të Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Drenas

(2024 – 2027)

Neni 1

APROVOHET Plani i Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës, Drenas, hartuar nga Grupi Punues Komunal.

Neni 2

Programi ka për qëllim përcaktimin e masave për realizimin e të drejtave, përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve, eliminimin e punëve të rënda për fëmijë, si dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësiive të subjekteve për mbrojtjen e fëmijëve, duke i përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta në Komunën e Drenasit.

Neni 3

Pas aprovimit të këtij propozim vendimi në Kuvendin e Komunës, për zbatimin e tij do të përkujdeset Kryetari i Komunës, dhe Drejtoratet përkatëse të Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky Propozim Vendim hynë në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës, dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga MAPL-ja, Prishtinë.



**Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci**

A r s y e t i m

Më Udhëzimin Administrativ Nr.06/2012 për Themelimin dhe Funksonimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, Kryetari i Komunës së Drenasit ka themeluar Ekipen për të Drejtat e Fëmijës me Vendimin Nr 01-030/01-17622 dt.13.01.2024 , ekip ky i cili pas takimeve dhe punëtorive të ndryshme, ka hartuar Planin e Punës për Ekipin Komunal për të Drejtat e Fëmijës (2024 – 2027) në mënyrë që të definoj prioritetet e Komunës dhe masat e nevojshme që duhet ndërmarrë në vazhdimësi për përmirësimin e situates në lidhje me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Gjithashtu hartimi i këtij plani do të mundësoj parandalimin në përfshirjen e fëmijës në dukuri të mundshme negative dhe do të mundësoj ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për të realizuar të drejtat dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijës në pajtim me legjislacionin në fuqi.